



R R E G U L L O R E
PËR
DHËNIEN E DEKORATA, CMIME DHE NDERIM TË
ANËTARËVE TË NDARË NGA JETA TË OFK-SË

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TE KOSOVËS në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-palagiafm 1.1 dhe Nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetëso, Nenit 21 parografi 1, me nënparagrin 1.1 dhe 1.22 të Statutit të OFK-së nr. 134 të datës 04/06/2024, e miratuat në mbledhjen e datës 14/12/2024, miraton këtë:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 270 Dt. 30/12/2024

RREGULLORE

PËR

DHENIEN E DEKORATAVE DHE CMIMEVE

I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet procedura dhe mënyra e dhënies së dekorata e dhe cmimeve vjetore, si dhe organizimi i ceremonive të nderimit me rastin e ndarjes ngajeta të anëtarëve të Odës së Farmacistëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: Oda).

Neni 2 **Fushëveprimi**

Dekoratat e Odës dhe çmimet vjetore të Odës janë mirënjojjet e dhëna nga Oda për anëtaret e saj të shquar, si dhe për individë të tjera, institucione, organizata dhe persona juridikë për kontribut të veçantë ndaj Odës dhe për promovimin e saj në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit për kontribut të veçantë në promovimin dhe ruajtjen e vlerave më të larta të klasës mjekësore dhe të profesionit të farmacisit si dhe në përmirësimin dhe zhvillimin e veprimtarisë farmaceutike.

Neni 3

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

Dekorata — Vlerësimi më i lartë i OFK-së për anëtaret kontribut dhënës në fushën e farmacisë.

Çmimet — që jepen për anëtaret që kanë të arritura shkencore në fushën e farmacisë.

Mirënjohe — e cila u jepet anëtareve të Odës dhe individëve të tjerë, institucioneve, organizatave, shoqatave e dhe personave juridikë për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës dhe farmacisë në përgjithësi.

Revokim i dekoratës - heqja e së drejtës dikujt, për bartjen e Dekoratës së dhënë nga Oda

Komisioni për Dhënien e Dekoratave - Organ i OFK-së i cili është përgjegjës për shqyrtimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave për dhënien e dekoratave.

Nderim i anëtarëve të ndarë ngajeta - Mbajtja e mbledhjes komemorative dhe pjesmarrja ne varrim e anëtarit të përcaktuar me këtë rregullore

Buxheti — Vijë buxhetore e ndarë për dekorata, çmime dhe nderime.

II. DEKORATAT E ODËS

Neni 3

1. Oda e Farmacistëve të Kosovës do të ketë 4 lloje të dekoratave, si në vijim:

- 1.1. Dekorata Nderi i Farmacisë
- 1.2. Cmimi për Arritje shkencore;
- 1.3. Mirënjoja e Odës së Farmacistëve të Kosovës;
- 1.4. Çmimet vjetore të Odës së Farmacistëve te Kosovës

Neni 4

Pamja vizuale (dizajni) i llojeve të dekorata e të dhëna nga OFK-ja sipas Nenit 3 të kësaj Rregulloreje përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 5

E njëjta dekoratë nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtë person.

Neni 6

Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërbirim në të holla, sipas kritereve që do të caktojë Këshilli Drejtues i Odës

DEKORATA NDERI I FARMACISTIT

Neni 7

Dekorata e Nderit, si vlerësimi më i lartë i Odës, u jepet anëtareve të Odës për arritje të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të profesionit të farmacisë në situata të krizës sociale ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshëm ose të rrrezikshme për jetën, si dhe për arritje të jashtëzakonshme profesionale që kanë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nivelin ekzistues të ofrimit të kujdesit shëndetësor, veprimtarin në kujdesin shëndetësor dhe sistemin e kujdesit shëndetësor në tërësi.

CMIMI PER ARKITJE SHKENCORE

Neni 8

Cmimi për arritje shkencore e Odës së Farmacistëve të Kosovës u jepet anëtareve të Odës të cilët kanë të arritura të vërtetuara në fushën e farmacisë, me kontributin e shprehur në nivel evropian dhe botëror.

MIRENJOHJA E ODES SË FARMACISTËVE TE KOSOVËS

Neni 9

1. Mirënjojja e Odës së Farmacistëve të Kosovës u jepet anëtarëve të Odës dhe individëve të tjeter, pas daljes në pension, institucioneve, organizatave, shoqata e dhe personave juridike për dhënien e kontributit të çmueshëm në punën dhe organizimin e Odës dhe për dhënien e kontributit në promovimin e vlerave të Odës e për ndihmën në realizimin e detyrave, programeve, projekte dhe qëllimeve thelbësore të Odës në Republikën e Kosovës dhe jashtë vendit.

2. Mirënjojja e Odës së Farmacistëve të Kosovës i jepet një anëtarë të Odës pas vdekjes si shenjë mirënjojjeje dhe falënderimi për anëtarësi të përgjegjshme shumëvjeçare dhe kontribut në punën e Odës së Farmacistëve të Kosovës si dhe në dhënien e shërbimeve e shëndetësore popullatës së Kosovës.

ÇMIMET VJETORE TË ODËS SË FARMACISTËVE TE KOSOVËS

Neni 10

1. Çmimet vjetore të Odës së Farmacistëve të Kosovës ndahen mbi këto baza:
 - 1.1 Anëtarit të Odës i cili me punën e vet profesionale në praktikën farmaceutike ka arritur rezultatet më të spikatura profesionale gjatë vitit të kaluar kalendarik në fushën e profesionit të farmacistit.
 - 1.2 Anëtarit të Odës i cili duke botuar punën e vet origjinale shkencore, si autor i parë në vitin e referuar në revistat shkencore me faktorin e indeksuar të ndikimit (*Impact factor*) së paku 2 në bazën e të dhënve *Web of Science apo Scopus* ka kontribuar në menynë të konsiderueshme në përmirësimin e profesionit të farmacistit. Nëse anëtar i Odës ka publikuar disa punime në revistën përkatëse shkencore në vitin e kaluar atëherë mblidhen faktorët e tij të ndikimit dhe arrihet e ashtuquajtura shumë e faktorëve të ndikimit. Nëse disa anëtarë të Odës kanë të njëjtën shumë të faktorëve ndikues të punimeve shkencore, çmimi vjetor i Odës së Farmacistëve të Kosovës do t'i jepet anëtarit të Odës i cili është autor i parë në më shumë punime shkencore të këtilla.
 - 1.3 Anëtarit të Odës i cili në mënyrë të veçantë, me veprimtari të jashtëzakonshme ka mbrojtur të drejtat e farmacistëve dhe ka kontribuar në promovimin e interesave të farmacisë kosovare.
2. Këshilli Drejtues i Odës vendos mbi vlerën monetare dhe formën e çmimit si dhe pamjen e mirënjoyjes me shkrim të çmimit vjetor të Odës.
3. Gjatë një vit mund të jepet vetëm një çmim vjetor i Odës së Farmacistëve të Kosovës mbi secilën bazë të cekur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 11

Dhënia e propozimit për dekorata të Odës së Farmacistëve të Kosovës

1. Propozimi për dhënien e dekoratave (Dekorata Nderi i Farmacistit; Dekorata për Arritje shkencore dhe Mirënjoyja e Odës së Farmacistëve të Kosovës) mund t'i dorëzohet Këshillit Drejtues të Odës drejtpërdrejtë nga:
 - 1.1. Kryetari i Odës;
 - 1.2. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës;
 - 1.3. Anëtarët e Kuvendit të Odës.
 - 1.4. Së paku 10 anëtarë të Odës
2. Propozimi për dekoratë dhe çmimet vjetore është i plotë nëse shoqërohet me arsyetim përkatës ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit me biografi të personit të propozuar.
3. Anëtarët e Odës nuk mund ta propozojnë vetveten për dhënien e dekoratës dhe çmimit vjetor.

4. Miratimi i propozimeve për dekorata është e drejtë e Këshillit Drejtues, i cili vlerëson propozimin, e miraton ose nuk e miraton, vendos për të dhënë dekoratë tjetër nga ajo që është propozuar ose e riformulon arsyetimin.

Neni 12 **Mënyra e dhënjes së dekoratave**

1. Dhënia e dekoratave vendoset nga Kuvendi i Odës në bazë të propozimit përfundimtar të Komisionit, përveç Dekoratës “Farcmacisti Nderi”
2. Për kohën, vendin dhe mënyrën e dhënies së dekoratave vendos Këshilli Drejtues i Odës, ndërkaq i dorëzon Kryetari i Odës ose personi i autorizuat prej tij.
3. Nëse i dekoruari nuk pranon ta merr Dekoratën atëherë veprohet sikurse Dekorata të mos ishte dhënë fare.
4. Vendimi për dhënien e dekoratave publikohet në Œeb-faqen zyrtare të Odës.
5. Vendimi për dhënien dhe revokimin e dekoratave përfshihet në një Libër të veçantë të dekoratave e cila mbahet në arkivën e Odës.

Neni 13 **Dhënia e Dekoratës pas vdekjes**

1. Dhënia e Dekoratës pas vdekjes së të dekoruarit i bëhet familjarëve të tij: bashkëshortit/tes, fëmijët, të adoptuarit, nipat/mbesat, prindërit, adoptuesit, vëllezërit dhe motrat e të dekoruarit.
2. Nëse i dekoruari nuk ka anëtar të familjes sipas paragrafit 1. të këtij nenit dhënia e Dekoratës publikohet në ueb-faqen zyrtare të Odës dhe ruhet si një pasuri e Odës.

Neni 14

Revokimi i dekoratës

1. Të dekoruarit, mund ti revokohet Dekorata nëse vepron në kundërshtim me Kodin Etik të Odës, moralin dhe kryen vepra tjera që e bëjnë të pa denjë për bartjen e Dekoratës.
2. Propozimin për revokimin e dekoratës mund ta bëjë propozuesi për dekoratë, Komisioni apo Kryetari i Odës.
3. Kryetar i Odës me aprovim të Këshillit Drejtues nxjerrë vendim për revokimin e dekoratës anëtarit të Odës.
4. Vendimi për revokimin e Dekoratës publikohet në ueb faqen zyrtare të Odës.

III. KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN E DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE VJETORE

Neni 15

Përbërja e Komisionit vlerësues

1. Komisioni vlerësues përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Odës që emërohen nga Këshilli Drejtues i Odës me propozim të Kryetarit të Odës, ku njëri prej tyre zgjedhet Kryetar i komisionit.
2. Mandati i Komisionit përcaktohet nga organi i cili e ka emëruar, përkatësisht Këshilli Drejtues i OFK-së.
3. Nëse kryetari i Komisionit ose një anëtar i Komisionit mungon pa arsyen më shumë se tre herë në takimet e Komisionit ose nuk i përmbush detyrat e veta në punën e Komisionit, Kryetari i Odës mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të Odës shkarkimin e tij dhe emërimin e një anëtarë të ri.
4. Detyrat administrative për nevojat e Komisionit ofrohen nga Asistenti administrativ i Shërbimit Profesional të OFK-së, i cili emërohet nga Kryetari i Odës.
5. Asistenca juridike e Komisionit i ofrohet nga Shërbimit Profesional të OFK-së.

Fushëveprimi i Komisionit

Neni 16

1. Komisioni mbledh dhe shqyrton propozimet për dhënien apo revokimin e dekoratave dhe çmimeve vjetore dhe përgatit propozimin përfundimtar.
2. Këshilli Drejtues i Odës përcakton punën e Komisionit Vlerësues për Dekorata dhe Çmimet vjetore me një akt të veçantë.

IV. NDERIMI ME RASTIN E NDARJES NGA JETA TË ANËTARËVE TË ORGANeve TË OFK-SË APO FARMACISTËVE ME KONTRIBUT TË VECANTË NE FARMACI

Neni 17

1. Cereminit e nderimit me rastin e ndarjes ngajeta të një personaliteti të vecantë janë të domosdoshme të organizohet të paktën në këto raste :
 - 1.1. Anëtarë dhe ish-anëtarë të organeve të OFK-së
 - 1.2. Kryetarë dhe ish-kryetar të shoqatës së Farmacistëve të Kosovës
 - 1.3. Profesorë dhe ish profesorë të Farmacisë në Universitetin e Prishtinës
 - 1.4. Persona tjerë me kontribut të vecantë në sektorin farmaceutik sipas vendimit të Këshillit Drejtues
2. Ceremonia e nderimit mbahen fjalime nga së paku :

- 2.1. Kryetari i OFK-së apo personi i autorizuar nga ai
 - 2.2. Përfaqësuesi nga institucionet qëndrore
 - 2.3. Mik/mikeshë e të ndjerit e përcaktuar nga familja
 - 2.4. Familjari i të ndjerit
3. Ceremonia nga paragrafi I-rë organizohet nga OFK në bashkëpunim me familjen e të ndjerit.
 4. Me rastin e ndarjes ngajeta të subjekteve nga paragrafi 1-rë, Kryetari i OFK-së apo personi i autorizuar nga ai, bën homazhe te varreza e anëtarit duke nderuar me kurore lulesh.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Kjo rregullore hyn në fuqi nga 1 Janari 2025

Prishtinë 14/12/2024



Kryetari i OFK-së
Mr.Ph. Kadri Bytyqi

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Bytyqi".